



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-060/01-99266

Pejë, datë: 30 Dhjetor 2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i –XI- të i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **30 dhjetor 2024**, me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z.Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina, asistente e kryesuesit znj. Florlinda Berisha: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 32 anëtarë prezent.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 30 vota pro (dy votë me ngritje dore),2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
 - 2.1 Betimi i anëtarës së re të Kuvendit të Komunës së Pejës nga subjekti politikë PDK, znj. Fjolla Dembogaj.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 29.11.2024.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të KPF-së.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Punës së KKS-së.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Bashkim Tatari, për realizimin e shtegut të ecjes buzë Lumit "Lumbardhë" me qëllim të përmbushjes së interesit publik sipas PZHK-së.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ryve (Halit) Muqolli, me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit "Lumbardhë".
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Valon (Rexhep) Kaliqani, me qëllim të regullimit të shtratit të Lumbardhit – hapjes së shtegut të ecjes buzë lumit "Lumbardhë" sipas PZHK.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronë private e pronarëve Ergin (Skender Krasniqi) me ¼, Newco Green Market L.L.C. me ¼, Ismet (Istref) Lajqi me ¼ dhe Nuriye (Sali) Lajqi me 1/4, me qëllim të ndërtimit të Qendrës së Skijimit në Bogë, si Interes Publik.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e

komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale - Parceles Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

16.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Parcelen Kadastrale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

17.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Parcelen Kadastrale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

18.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

19.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për korrigjim të transferit të kategorive ekonomike në kategorinë paga dhe shtesa.

21.Shqyrtimi i Raportit të Punës së NJAB mbi nivelin e rekomandimeve për 2024.

22.Shqyrtimi i informatës së NPL-ve të Komuns s Pejës.

23.Shqyrtimi i Planit Preliminar të Prokurimit për vitin 2025.

24.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

25.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan z.Rrustem Berisha, z.Granit Kelmendi,znj. Drita Maloku, z.Atdhe Berisha.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.

Nuk ka pasur.

2.1. Betimi i anëtares së re të Kuvendit të Komunës së Pejës nga subjekti politikë PDK, znj. Fjolla Dembogaj.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, e ftoj anëtares e re të Kuvendit të Komunës znj. Fjolla Dembogaj nga subjekti politik PDK që ta jap betimin, pas vendimit të KQZ-së mbi emrimin e saj, duke zvendësuar anëtarin poashtu nga i njejti subjekt. Pas betimit të anëtares së re është anëtare e kuvendit me drejta të plota.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 29.11.2024.

Nga të gjithë anëtares prezent me 28 votë pro (2 votë me ngritje dore), 4 votë të përmbajtur u miratua procesverbali i K.K. Pejë, dt. 29.10.2024.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zvendësimin e anëtarit të KPF-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: meqenëse anëtarja e kuvendit znj. Xhevahire Ceku ka dhënë dorëheqje, duhen të zvendësohen nga i njejti subjekt më anëtarin tjetër.

Z. Rajan Arapi: e propozojë z. Leotrim Myrtezaj.

Më 29 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 1 anëtar nuk ka marrë pjesë në votim, zvendësohet anëtarin i kuvendit në KPF, dhe anëtarin i ri është z. Leotrim Murtezaj.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Punës së KKSBS-së.

Nënkryetari z. Fatmir Asllani: besoj që të gjithë e keni marrë më kohë draft planin për vitin 2025 të KKSBS-së, është i zakonshëm sipas udhëzimit administrativ ky plan është aprovu në KKSBS dhe është sjell tek ju për aprovim si draft. Shëndetsia, arsimi, ambienti, mjedisi urban, siguria dhe të drejtat e njeriut, janë 6 pika kryesore që do të diskutojmë edhe gjatë vitit 2025. Pika shtesë që është kërkuar të jetë është objektet vitale kritike që janë më rrezikshmëri të lartë, në këtë draft nuk e keni për shkakë të problemve teknike, nëse është e mundur të përfshihet edhe kjo pikë, po besoj që është më interes që të jetë edhe kjo pikë në diskutimin e KKSBS-së.

Z. Najm Bytyqi: draftin për KKSBS-së e lëshova me vëmendje, qellimi është që të sqarohet mirë dhe të vendoset edhe një pikë për raportim për ngjarjet të cilat po ndodhin. Të objektivat e këtij drafti kam verejtur, rritja e sigurisë në shkollë në të gjitha nivelet, ne e dim së vetëm në muajin dhjetor kanë ndodhur 2 therje më thikë, në dy shkollat e komunës së Pejës, njëra në shkollën "8 marsi" ndërsa tjetra në shkollën "Xhemajl Kada" e cila ndodhi javën e kaluar. Do të thotë unë mendoj që drafti është shumë i mangët edhe duhet më u vendosë si pikë kryesore të raportohet 3 herë në vitë çdo tre muaj në kuvend që të japim edhe ne mendimin tonë. Një pikë tjetër meqenëse është këtu prezent edhe drejtori i arsimit, është sulmet e denigrimit të cilat po ju bëhen arsimtarëve në shkollë, të cilat janë të pa raportime, mendoj unë që janë të mbuluara nga drejtorët e shkollave, nuk e di a është i informuar drejtori. Shfrytëzoj rastin si anëtar i asamblesë komunale të ju bëjë thirrje drejtorëve në shkollë, le të jenë të pa ngarkuar politikisht, ti mbrojnë

arsimtarët, po ju lusë sepse një ditë do të ndërrohet qeverisja lokale dhe më këta drejtor do të merret dikush dhe nëse nuk e kanë kryer punën si duhet kanë më shku në shtëpi. Është edhe ky vitë deri në zgjedhje në vjeshtë, merruni seriozisht më kercenimç dhe denigrime që po ju bëhen arsimtarëve në shkolla, mos i mbulonit.

Nënkryetari z. Fatmir Asallani: më të tregu shumë sinqerisht nuk i ndalë askush arsimtarët më i raportu rastet. Nuk besoj që ka fuqi drejtori i shkollës më i ndalu mësimdhënsit më i raportu rastet. Unë vetëm deshta ta jap një përgjigje rreth raportimeve për KKSB-së, drejtori i arsimit është në 6 seanca sepse është edhe anëtar i KKSB-së, komandati i stacionit policor poashtu është ku raportojmë për rastet, i diskutojmë dhe të gjitha çështjet na vijjnë në janar në planin e punës për vitin 2024 që e kemi kryer, mirëpo ato raste siç i the ti nuk mundet askush mi ndalu për tu raportuar.

Z. Naser Gega: nuk janë dy therje, ne merremi me çështje konkrete dhe jo më çështje të mediave. Është një therje dhe një vajzë e kanë zenë më thikë duke dashur të hyjë në shkollën "Xhemajl Kada", ky është realiteti. Tek raportimet, unë çdo gjë përkrahi por heshtjen nuk e përkrahi asnjëherë në asnjë shkollë. As nxënësve, as arsimtarëve dhe as prindërve nuk ju ndalohet të raportojnë në asnjë situat.

Z. Nezir Jahmurataj: unë vetëm tek pika e drejtorisë së shërbimëve publike, ishte cek për sigurin e pjesëmarrësve në trafik sidomos njerëzve por edhe vetuarve. Kisha kërku le ti përcjell të gjitha udhëkryqet i kemi pa zebra dhe pika e autotregit në Raushiq, e cila është shumë e rrezikume për këmbësor dhe për njerëzit të cilët udhëtojnë, andaj është mirë deri në fund të këtij mandati kryetari më zgjedh çështjen e autotregit.

Z. Drin Veselaj: unë dua të ndalem tek siguria e nxënësve në oborre të shkollave, por është më rëndesi edhe siguria jashtë oborrit të shkollës. Ne e dim që tash ka një ngarkesë të rrugëve më automjeteve edhe prej prindërve që shkojnë ti marrin fëmijet. Unë kisha kërkuar që të merren shumë seriozisht vendosja e pengesave afër shkollave. Andaj është shumë e rëndësishme vendosja e tyre e sidomos tek shkollat të cilat e kanë një frekuentim më të madhë.

Z. Berat Ganiqi: po pajtohem më z.Drinin deri diku por më shumë thirrje për prindërit e qytetit të Pcjës, sepse pak a shumë ne si prind mundemi më përmisu këtë gjendje, meqënëse shumë prind e bëjnë parkingun afër shkollave për ti marrë fëmijët. Edhe shohë shumë njerëz të pa nevojshëm që i kanë edhe shtëpit afër, i ngarkojnë komplet trotuarët. Andaj është një apel që duhet ta bëjmë të gjithë sepse edhe kjo paraqet rrezik për ata fëmijë, sepse nga ngarkesa e madhe e automjeteve ka fëmijë që nuk shihen duke e kaluar rrugën edhe mundet me ardhë deri tek aksidenti. Unë më shumë kisha ardhur në përfundim më i blloku trotuarët afër shkollave, poashtu më i vendos policët e shtrirë.

Z. Rajan Arapi: e kemi vërejtur fenomenin e mjeteve të rrezikshme që fëmijet po i mbajnë, u përmend edhe më herët nga nënkryetari që ka pasur edhe kontrole, dhe sa herë që ka pasur kontrole janë gjetur në numer të madhë thika, boksa e kështu më rradhë. Këto kontrollat ish dashtë të shtohen, e dim që siguria në shkolla është problematike. Nëse këto kontrollat shtohen pastaj edhe mundësia për më ndodhë diçka zvoglohet, sepse e dim që çdo moment mundet më hy dikush më i kontrollu dhe mundet më ju gjetë. E kemi rastin para disa ditëve, kur një vajzës ju ka gjetë në qantë thika. Ne po ndëgjojmë raste të ndryshme në botë se çfarë po ndodhë nepër shkolla, pra mos të vijm edhe ne në atë situatë t'i shtojmë kontrollat.

Më 28 vota pro, 1 votë kundër, përmbajtur nuk ka, 1 anëtarë nuk ka marrë pjesë në votim, mirtohet Plan i Punës së KKS-së.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Bashkim Tatari, për realizimin e shtegut të ecjes buzë Lumit "Lumbardhë" me qëllim të përmbushjes së interesit publik sipas PZHK-së.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: Është kjo shetitorja përfundi Urës së Gurit që shkon në drejtim të ish tregut të gjelbërt. Pronari z. Bashkim Tatari është në Sucdi dhe nuk kemi mundur të merremi vesh më të atëherë kur është hap shetitorja dhe tash ka ardh rendi më e rregullu këtë çështje për më qënë shetitorja pronë publike. Si zëvendësim ne po e japim një pronë 58m më 56m, që ai e ka në shfrytëzim para shtëpisë. Është hymja tek garazhda e tijë. Është vetëm rregullim i parcellës, më parë kjo punë është kryer pa ardhur në kuvend, ishë dashur ta kryj shërbimi pronësorë juridik më pronarin e kësaj shtëpie. Tash është sjellur çdo gjë të kryhet këtu, që të mos mendojnë njerëzit që po bëhet diçka e paligjshme.

Z. Labinot Panxha: nga tani e tutje në këtë rend dite do të diskutohet vetëm për këmbime e dhënjë në shfrytëzim të pronës komunale dhe atë në emër të përmbushjës së interesit publik, mirëpo në bazë të këtij dokumentacioni që e kemi të gjithë përpara, vërtetohet dhe deshmohet që vetëm përmbushje të interesit publik nuk ka. Siç e dini prona komunale tash e një dekad këmbëhet vetëm për interesa personale të njerëzve të afërt më pushtetin, dhe duke marrë parasysh këtë fakt të gjithë e dimë që kryetari z. Gazmend Muhaxheri gjithmonë është treguar zemërgjerë më këta njerëz, duke ja'u këmbyer pronën komunale 5 fishë në dobi të tyre, dhe pa i interesuar që këto prona janë në procese gjyqësore dhe e përmbushin interesin publik. Për dijenin e qytetarëve ky kryetar tash e një dekad e ka shpërfillur ligjin për dhënjë në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe si pasojë janë hetuar dhe ngritur aktakuza ndaj zyretarëve të kabinetit të tijë duke përfshirë edhe ish drejtorë. Mirëpo kryetari ka vazhduar njëjtë pa ju trembur aspak ligjit. Të nderuar kolegë, për ta vërtetuar këtë që po them, shikone materialin që e kemi përpara. Të gjitha pronat komunale që janë sjellur për këmbim sot këtu, në to janë të ndertuara objekte afariste dhe objekte banimi nga opuzpatorët që z. Muhaxheri nuk guxon më e sjellë listën e tyre këtu, mirëpo ka zgjedhur në mënyrë të kundër ligjshme më i legalizu pronat e tyre. Pra ky kryetar është shumë i vendosur më e tregtu pronën e komunës në emër të interesit

publik, por edhe ne jemi të vendosur më e kundërshtu dhe parandalu. Për këtë e kërkojë edhe mbështetjen e të gjithë juve që jeni të pranishëm në kuvend dhe mos e harroni një pjesë të paragrafit të betimit të asambleistit, pra nëse i pëmbahemi këtij betimi sot këto prona këtu nuk kalojnë.

Kryesusi z.Rexhep Kurtbogaj: nuk mundesh të bësh thirrje në emër të të gjithë asambleistëve, ngrite tek çështjet e ngritura, përndryshe ta ndali fjalën.

Kryesusi i Kuvendit z.Rexhep Kurtbogaj ja ndal mikrofonin z.Labinot Panxha.

Z. Berat Ganiqi: nuk po më duket në rregull më i ndalë fjalimet, është e drejtë e secilit më diskutu, a i bën thirrje a nuk i bën është e drejtë e tijë jo e juaj. Në lidhje më këtë pikë deshirojë të dijë kjo hapsira që japet çfarë pronë është. Pronë komunale po e di, por nuk po mundem me dallu a është trotuar apo oborr?

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: janë prona që i kanë para shtëpive dhe i kanë hymjet në garazhda para 20 ose 30 viteve. Ajo nuk është më një shfrytëzim të qytetarëve dhe rruga është shumë e gjerë nuk e cenon as trotuarin as rrugën.

Z. Berat Ganiqi: vetëm sa për sqarim për qytetarët e Pejës dhe për të gjithë, ne e kemi sqaru që nuk jemi kundër këtyre llojeve të këmbimit, më aq sa e kemi parë materialin për ne është në rregull, pa dyshim që e votojmë këtë pikë, por pastaj në çdo pikë tjetër e arsyetojmë dhe pasqyrojmë kundërshtimin tonë ku e kemi.

Anëtarët e subjektit AAK e lëshojnë seancën.

Më 23 vota pro, 1 përmbajtur, kundër nuk ka, 6 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet këmbimi i pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Bashkim Tatarsi, për realizimin e shtegut të ecjes buzë Lumit "Lumbardhë" me qëllim të përmbushjes së interesit publik sipas PZHK-së.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ryve (Halit) Muqolli, me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit "Lumbardhë".

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: janë 21 procedura që duhet ti bëjmë dhe 6 muaj po na i mer kohë një procedurë. I kemi 74m që zonja i ka para shtëpisë dhe i shfrytëzon dhe gjithmonë janë në shfrytëzim të saj. Ne po ja marrim 74m për me mujtë më hap prej "Isuf Gervalles" më dalë në shetitore.Kjo edhe ashtu përdoret prej kësaj familjes dhe nuk mundesh me ja ndalë të drejtën e pronës që e ka përpara, do më thënë çfarë po bëjmë ne po e krijojmë një hapsirë publike që e perdorim ne me një hapsirë publike që e përdorë ajo zonja ose familja që e ka në shfrytëzim.

Më 24 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 6 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim gjithashtu nuk janë prezent, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës

së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ryve (Halit) Muqolli, me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit “Lumbardhë”.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Valon (Rexhep) Kaliqani, me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit – hapjes së shtegut të ecjes buzë lumit “Lumbardhë” sipas PZHK.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: ne i kemi propozu më i marrë diku 14m prej bustit pronën e këtij z. Kaliqani dhe me kriju parcellen tjetër, më levizë diku 9 ose 10m në drejtim të objektit egzistues, dhe trotuarin më pasë pronë publike sepse i duhet komunës dhe kjo pjesa tjetër prej bustit largohet diku 13m. Do më thënë kjo është rregullim i parcellës dhe lirim i një hapsire gjelbëruse.

Z. Berat Gaqniqi: edhe këtë e kam analizuar por e kam problem në ortofoto nuk dihet as ku fillon parcella as ku përfundon. Vizatimi është i tillë ku tri parcella e prekin njëra tjetrën dhe nuk po besojë që është ashtu, këtë që e kam unë është më vija të verdha dhe është shumë konfuzë.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: kjo është bërë më gjedect, parcella e tij është kjo e madhja që ka qënë në rrugë, ne ja kemi jep dhe i kemi nderru dy parcella, një që është buzë lumit dhe tjetra që ka qënë ngjitur më këtë. Ka mbetë edhe një pjesë e parcellës tij për më mbetë këtu. Ne i kemi marrë diku 2 ari parcell dhe e kemi lëvizë. Tani parcella e tij mbetë katrore në fund, por kjo parcella më këtë bishtin e trotuarit i kalon komunës. Do më thënë 13m largohet nga pjesa ku është busti dhe ku e ka ai garazhdën, prej garazhdës e tek ne bëhet pronë publike dhe bëhet vijë e drejtë deri tek lumi. Një pjesë e parcellës tij i mbet atij, ne e marrim më shumë se gjysmën e parcellës por një pjesë nuk na duhet dhe i mbetë atij. Më dy parcellat tjera që e ndërrojmë diferenca është 1 ari e 30, e këtë diferencë i bie që ai të na paguaj neve, pra privati më kompenzu komunën.

Më 17 vota pro, kundër nuk ka, 7 përmabjtur, 6 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim gjithashtu nuk janë prezent, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Valon (Rexhep) Kaliqani, me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit – hapjes së shtegut të ecjes buzë lumit “Lumbardhë” sipas PZHK.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronë private e pronarëve Ergin (Skender Krasniqi) me ¼, Newco Green Market L.L.C. me ¼, Ismet (Istref) Lajqi me ¼ dhe Nuriye (Sali) Lajqi me 1/4, me qëllim të ndërtimit të Qendrës së Skijimit në Bogë, si Interes Publik.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: kjo është ajo pjesa e ski liftit në Bogë, një pjesë më heret e kemi kry, tani është ndërtimi i kësaj prone 1 ha 8m², po e ndërrojmë më një pronë ku pronari e ka ndërtu hotelin në pronën publike, hoteli është që 15-20 vite. Po ndërrohet me një tokë që është

tek kombinati i këpucëve, këto shtëpi janë të ndërtuara para luftë, janë 7 ari, dhe tek motel "Karragaqi" janë 1 ari e gjysmë. Do të thotë janë 3 pronar ku vlera e kësaj pronë është 400.000 euro.

Z. Berat Gaqniqi: nuk jemi kundër atyre hapsirave për më u kriju për tu bërë ski- lifti, po përshembull kjo ngastra kadastrale 5755/71, këtu shihet që është ndërtua një shtëpi e madhe ku i duket kulmi që është i ri. Gjithë ky ndërtim ka kaluar në mënyrë të heshtur, nuk e di a në këtë pushtet lokal apo në tjetrin, duke i mbyllur syt edhe inspektorat e ndërtimarisë edhe ish drejtorat e urbanizmit. Kjo na bën në këmbime të tilla të pronavë, jo të jemi kundër interesit për ski liftin, po me qenë kundër interesit pse një ndërtesë kaq e madhe duhet më u legalizu kur ka qënë gjatë gjithë kohës në kundërshtim më ligjin. Çfarë mesazhi kemi më dhënë tek qytetarët tjerë që kanë më ndertu në prona publike më rënu, kur ai mundet më thënë para disa viteve ka ndertu edhe ky tjetri por ju nuk ja keni rënuar. Do të thotë dikush duhet të jap përgjigjthsi në këtë aspektin kush e ka leju më ndertu këtë, sepse kjo na kish sherbyer sot mos më bë këmbim, por ish përdor si hapsirë komunale. Unë e di që Peja ka shumë telashë pronësore, por po kam frikë që jemi tu i jap shembull qytetarëve tjerë më vepru në këtë llojë mënyrë.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: këtu është pronë publike dhe i kemi dy mundësi, me ja lënë këtë në shfrytëzim pa para më i bë avantazh dhe tjetra më ja marrë buxhetin e vlerësuar realisht. Këtu janë 8 shtëpi të ndërtuara në 60 ari pronë komunale tek kombinati i këpucëve. Aty vlera e pronës ka shkuar diku 12.000-14.000 euro dhe askush nuk shkon aty më ja' u rënu sepse janë para dhe pasë luftës dhe janë me fasada e nxemje qendrore. Nuk mundesh me rënu një shtëpi 200.000 -300.000 euro sepse e kalon vlerën e tokës tre fishë. Më mirë është më ja' u marrë në këtë buxhet e mos më shpenzu komuna. Më fitu diçka më kriju një hapsirë publike që shfrytëzohet në të ardhmën prej komunës. Këto nuk mundet më u shfrytëzu asnjëra nga këto parcella e pasi që nuk është në shfrytëzim është më mirë më kriju vlerë prej diçka që nuk ka vlerë hiç. Jam munduar më ju sqaru të gjithë kryeministrave, komuna ka nevojë më shpronësu diku 24.000.000 milion euro, vlerë të komunës të ozurpuar ka mbi 200.000.000 milion euro, vetëm duhet me pasë nerva më e analizu këtë interes publik. Ne po e pengojmë vetëveten sepse kemi inate të ndryshme, kur ka qënë puna për anëtarët e tyre (AAK-së) kanë qendruar dhe kanë votuar të gjithë, kurr nuk kanë qënë njerëz të LDK-së që kanë ardh më kërkun ndërrime, por kanë qënë njerëz të tyre që ne ju kemi ndihmu dhe ju kemi zgjidh hallë, por edhe komunës i kemi krijuar interes publik, sepse nuk i kam ndërruar unë ato punë pa qënë interesi publik i realizuar.

Z. Berat Ganiqi: Po ky është problemi se ne jemi duke e zgjidh një problem sot, por jemi duke i lënë edhe 99 probleme tjera dhe mundet më ngritë paknaqësi tek qytetarët tjerë. Ne e dimë ndërtesat tek ish kombinati që ju thuhet objekte banesore e në fakt janë shtëpi, të gjithë janë në hapsira që i shfrytëzojnë, nuk janë në prona të tyre, do më thënë ata e shfrytëzojnë vetëm ndërtesën. Këtu e kam problemi, sepse po krijon pabarazi në mes qytetarëve. Çështja tjetër është që duhet më lobu sa më shumë legjislaturën e re më bë një ligjë që e rregullon këtë problem. Një ligjë që qytetari mundet më ble pronën vet dhe me pagu sipas viteve, këtu pajtohem sepse kështu mundet më i rregullu këto probleme.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: Ligji bazik i cili ka funksionu sepse ka qënë më bazë gjermane e ka trajtu këtë punë dhe ka qënë e mundur komuna më ja shit 5,10,15,50 m privatit për më kriju parcellën ndërtimore. Më ligjin për pushtetin lokal kjo atehere është pa mundesu, do më thënë komunës i është lënë mundësia vetëm më e ndërru pronën komunale, jo më shitë.

Më 17 vota pro, 6 kundër, 1 përmbajtur, 6 anëtarë nuk kan marrë pjesë në votim, gjithashtu nuk janë prezent, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronë private e pronarëve Ergin (Skender Krasniqi) me ¼, Newco Green Market L.L.C. me ¼, Ismet (Istref) Lajqi me ¼ dhe Nuriqe (Sali) Lajqi me 1/4, me qëllim të ndërtimit të Qendrës së Skijimit në Bogë, si Interes Publikë prezent

10.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me siperfaqe 10085m2, ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: po flasë për të trijat sepse trijat janë një temë dhe një parcell. Do më thënë është parcella në Lutogllavë afër deponis së mbeturinave, njëherë na është kërku për ta bër për material guri, beton, tulla, material demoluës, për t'i recikluar. Tani në presion jemi të këtyre të gumave të automjeteve sepse janë duke i hedhur në lumë, në Rugovë buzë ujit.Do më thënë është bërë kritike masa e gomave dhe më mirë është më pasë një vend ku i grumbullojmë e më pasë ndoshta i gjindet një zgjidhje. Ndërsa pjesa e tretë është kërkesë këto ivericat, mbeturinat që janë material druri, më i mbledhë edhe më i reciklu. Pasi që i kemi pasë aty 3 ha tokë aty në afërsi i kemi ndarë, për ta dhënë në shfrytëzim atyre që dua të merrën më reciklim.

Z. Berat Ganiqi: vetëm e kam një problem sepse të gjitha deponit janë në fshatin Lutogllavë dhe jemi duke e mbingarku si fshatë. Jemi duke krijuar ndotje të ambientit për ta, thjeshtë mos është dashtë më shiku diku ndonjë hapsirë tjetër, sepse mua po më duket që fshati Lutogllavë është i mbingarkuar nga ndotja, duhet më pasë parasysh shëndetin e atyre banorëve dhe asaj trevë që e përfshinë.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: për besë është i vetmi vend që komuna i posedon 44 ha, nuk ka askund tjetër hapsirë publike, 23 ha janë drejtpërdrejt të komunës, 21ha janë edhe te AKP-së, jemi duke biseduar me qeverinë dhe më menaxhimin e deponisë së mbeturinave si më e zgjidhë këtë problemin e 21 ha, më mbulu këtë deponin e madhe e më pasë besojmë që deponia e vogël ka më qënë më lehtë për tu menaxhuar.

Z. Nezir Jahmurataj: për mobileri jam shumë i pajtimit, sepse Peja ka nevojë shumë. A ka sipërfaqe të lirë tokës në mes Zagermës dhe Raushiqit? Sepse aty ka fabrika të mobilereve dhe më e bë aty hapsirën për ti hedhur, ose kisha propozuar më pastru mirë hapsirën në mes Zagermës dhe Lybeniqit, pasi që është një hapsirë e madhe pasi rruga është e ndërtuar deri aty.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: sipërfaqja lha nuk është shumë e madhe, ndonjëherë po duket shumë e madhe,por për guma po besoj që ka më qënë e vogël. Nuk kemi mundësi më i dergu dikun tjetër. Ata që e kanë hallin e gumave na kanë bërë presion gjatë gjithë kohës.Tash po e shoh që nuk po vijnë në komunë të bëjnë presion, por janë duke i gjuajtur në lumë. Tek ura e KFOR-it komplet lumi është i mbushur më guma që i ka hedh dikush. Ishte idea që më i mbledhë të gjitha gumat e Republikës së Kosovës në një vend, por nuk po bëhet ajo punë. Kështu që në e bëjm,të paktën mundet më shërby si transfer kjo pika që e bëjmë ne dhe më pasë ku e cakton qeveria le ti mbledhin.

Më 20 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 10 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m2, ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite.

11.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m2, ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Më 15 vota pro, 1 përmbajtur, kundër nuk ka, 14 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m2, ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite.

12.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m2, ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Më 15 vota pro, 1 përmbajtur, kundër nuk ka, 14 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale, Parcelea Komunale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m2, ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: janë ato hapsirat që kanë qënë më parë zyrat e ish QPS-së. Janë duke shkuar dëm, menduam të ipen për 10 vite por njerëzit nuk po kanë llogari njerëzit më ardhë më i renovu, kështu ipen në shfrytëzim për 35 vite, më i shfrytëzu për hapsira për avokaturë.

Z. Berat Gaqniqi: Duhet më e mendur mirë si dojmë më e dhënë në shfrytëzim, sepse kjo është pronë komunale, ma mirë do të ishte më e dhënë për ndonjë rast social, si hapsirë që mundet më shërby diçka, se sa për avokaturë ose biznese private të cilat deri tani nuk ka avokaturë që nuk ka zyre të saj aty. Dikujt i konvenon më ardhë aty përballë gjykatës por më mirë më ju referu ndonjë rastit i cili ka nevojë se, sa avokaturës.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: ato kanë qënë zyre dhe janë aq të demtuara sa kanë fillu më i bë dëm edhe atyre pëfundri kur po pikë uji. Nëse paraqitet dikush që e merr në rregull, nëse jo ajo mbetet ashtu. Por është hapsirë që më shku me shiku nuk mundet të përdoret për banim.

Z. Nezir Jahmurataj: afati kohor 35 vite po më duket shumë i gjatë, nuk e dimë së çfarë bëhet dhe ndoshta i paraqitet komunës ndonjë nevojë. Ish dashtë më ditë sa na kushton neve më e bë renovimin e asaj pjesë, sepse po më duket kohë e gjatë.

Nga 20 anëtarë prezent, 15 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 15 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: këtë e kemi rregulluar, është e bërë më të gjitha, por pjesën e sipërme për gastronomi nuk kam pranuar më investu sepse edhe ashtu duhet më ja dhënë dikujt. Është më mirë më e marrë dikush që don me investu, se sa më e rregullu ne e më pasë më ja dhënë dikujt. Do na duhej më investu 200.000 mijë euro, më kuzhin dhe të gjitha e më pasë më ja dhënë dikujt të gatshme, andaj është më mirë më marrë dikush në shfrytëzim më kohë më

investu dhe komunës më ja pagu një qera. Është ankand publik, kush jep më së shumti dhe mendon më e rregullu atë pjesë, mundet më e marrë.

Nga 20 anëtarë prezent, 15 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 15 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale - Parceles Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Kryesusi z. Rexhep Kurtbogaj: dy anëtarë të cilët nuk mundën të jenë të propozuar për këto komisione janë z. Shqiprim Muriqi dhe z. Bujar Agusholli, të cilët janë në komisionin e ankesave dhe komisioni i ankesave është komision dy vjeçar, në këtë rast është komisioni specifik për secilen pronë që ipet në shfrytëzim.

Znj. Kaltrina Lajqi: nga subjekti LDK e propozojmë znj. Dafina Dragaj.

Z. Berat Ganiqi: meqenëse ne as nuk morem pjesë në votim dhe nuk e shohim të përshtatshme, andaj ne nuk e prozojmë askend në asnjërin komision.

Z. Rajan Arapi: nga subjekti PDK e propozojmë znj. Fjolla Dembogaj.

Kryesusi z. Rexhep Kurtbogaj: meqenëse grupi i subjektit të AAK-së nuk janë prezent që e kanë lëshuar sallën, pjesë e këtij komisioni janë: znj. Dafina Dragaj, znj. Fjolla Dembogaj, znj. Edonjeta Berisha, znj. Diellza Berisha dhe z. Nexhat Meroci.

Nga 22 anëtarë prezent, 15 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 15 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale - Parceles Komunale 00167/41, pronë komunale në fshatin Lutogllavë me sipërfaqe 10085m², ZK Lutogllavë e cila është e destinuar për deponi druri e që është e planifikuar të ipet në shfrytëzim për 15 vite.

16. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Parcelen Kadastrale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Znj. Dafina Dragaj: nga subjekti LDK e propozojmë znj. Kaltrina Lajqi.

Z. Rajan Arapi: nga subjekti PDK e propozojmë znj. Fatime Shala.

Nga 22 anëtarë prezent, 15 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 15 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Parcelen Kadastrale 00167/42, pronë komunale, fshati Lutogllavë me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi - material i fortë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite.

17.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Parcelen Kadastrale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite;

Znj. Kaltrina Lajqi: nga LDK e propozojmë z. Atdhe Berisha.

Z. Rajan Arapi: nga subjekti PDK e propozojmë z. Leotrim Murtezaj.

Nga 23 anëtarë prezent, 16 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 15 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Parcelen Kadastrale 00167/43, pronë komunale, fshati Lutogllavë, me sipërfaqe 10086m², ZK Lutogllavë, Deponi – Gomë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 15 vite.

18.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

Znj. Kaltrina Lajqi: nga LDK e propozojmë z. Luan Pavataj.

Z. Skender Kandic: nga BIP e propozojmë z. Izet Kojic.

Nga 23 anëtarë prezent, 13 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 18 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale – Zyret e ish QPS-së, përkatësisht në objektin e Soliterit, në Pejë, pronë komunale, janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite.

19.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së

paluajtshme Komunale - Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

Znj. Dafina Dragaj: nga subjekti LDK e propozojmë z. Mentor Bajraj

Z. Rajan Arapi: nga subjekti PDK e propozojmë z. Rajan Arapi.

Nga 23 anëtarë prezent, 15 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 16 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për korigjim të transferit të kategorive ekonomike në kategorinë paga dhe shtesa.

Znj. Hajrie Haxhijaj: Ne e kemi dërguar një kërkesë në lidhje me korigjimin e këtyre shpronësimeve që kanë ndodhur për shkak të pagesave nga vendimet gjyqësore. Ne jemi bazuar në ligjin e buxhetit dhe ligjin mbi menaxhimin e financave publike, ku tre mujorin e fundit ju lejohet komunave që të bëhen këto harmonizimi të mjeteve që janë të shpenzuara nga kategoria e investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimëve, subvencioneve, transferëve dhe shërbimëve komunale, në mënyrë që ne ti rregullojmë këto kategori dhe të bëhet një harmonizim i planit kontabël. Qellimi i këtij transferi është që ne ti ikim keqklasifikimit i cili ndodhë me rastin e prezantimit të pasqyrave financiare që vjen deri tek mohimi i opinionit, për shkak të gjetjes së kësaj dukurie që nuk shkaktohet nga ana jonë, por shkaktohet për shkak të pagesave të kontratës kolektive që po merren për paga dhe meditje, të programit asrim dhe shkencë. Kjo shuma është 806,131.00 mijë euro, ku prej grandit qeviratë janë 339.817.00 mijë euro dhe prej të hyrave vetanake 454.765.49 mijë euro, ndërsa prej të hyrave të bartura shpenzimi 11,548.49 mijë euro. Kjo është shumë më të cilën është bërë pagesa e vendimeve gjyqësore të kontratës kolektive për drejtoratin e arsimit. Ne kishim kërku ta mbeshetni këtë kërkesë për arsye që përmes këtyre vendimeve ne mund të ikim keqklasifikimit, që po e ndeshkon edhe opinionin tek pasqyrat financiare.

Z. Berat Ganiqi: një pyetje psh. tek ndërtimi i sheshit po i heqën 56.154.00 mijë euro, sa ka me ndiku në ndërtim të sheshit kjo heqje? Po ashtu tek heqja e ndërtimit të ujësjellësit të Lugut të Baranit 1177.69 cent?

Znj. Hajrie Haxhijaj: Shpenzimi ka ndodh, edhe nëse e aprovojmë, apo se aprovojmë në këtë transferë shpenzimi ka ndodhë. Këto mjete janë shpenzuar për kontratën kolektive, për kategorinë paga dhe meditje.

Z. Berat Ganiqi: Po e kuptojë që i ka marrë përmbarusi, por sa po penalizohen projektet, sa kanë me mbetë mbrapa, a po penalizohen që mos me u bo edhe në vitin 2025? Sepse janë projekte kapitale dhe unë pe di që janë terhek parct se ata diku janë duft me i marr dhe na këtu jena duke transferu shpraztë, ska pare po janë suke bo transferime jam duke e kuptu komplet! Por keto projekte sa kanë me mbet mbrapa? A kemi me pa korzen qashtu gjysë të ndërtume dhe a kemi me pa ujësjellësin e Lugut te Baranit të implementuar? A është gjet buxheti për vitin 2025 për me i mbulu këto vrima që krijohen!

Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri: Këto ish dashtë qeveria më i mbulu po nuk ka pasë vullnet. Në vitin tjetër nëse kemi rritje buxhetore, duhet më i mbulu më rritje buxhetore Lugu i Baranit me i nda mjetet menjehere, nese ka ritje i ndajmë edhe për sheshin!

Z. Berat Ganiqi: Për më i mbulu qeveria nuk e di a ka pas kërkesa, sepse kjo bëhet me morandume të bashkpunimit në mes ministrive dhe komunes, nuk kam parë kërkesa të tilla. Qeveria nuk mundet më i mbulu kur nuk e din si është gjendja në komunë.

Z.Nezir Jahmurataj: unë para mbledhjes së kaluar e kam pa një program që qeveria, ministri i financave thotë: ka nda 15 milionë euro për komunat që kanë pasu goditje prej kontrates kolektive. A ka përfitu komuna e Pejës a po jo?

Znj. Hajrije Haxhijaj: po komuna e Pejës ka përfitu në këtë shumen e15 milionë euro, për arsye se paga e muajit 12 ka qenë e shpenzuar për komunën e Pejës kah vendimet gjyqësore.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: pagat është e obligueshme që 3 mujorin e fundit qeveria me i nda, po kta e kanë zgjedhë mos me i mar prej pagave por prej investimeve kapitale, sespe kanëmujt mi mar ma heret prej pagave dhe me u pagu krejt ky borgj 3.5 milionë euro. Mandej qeveria me na qit pagat dhe me i mbulu. Por i ka mar prej investimeve kapitale që nuk është dashtë me i mar, sepse në ligjin e financave publike i tregon që pagat t'i mer veq prej pagave, por e kanë shkel këtë pikë të ligjit dhe kanë vazhdu me punu.

Nga 23 anëtarë prezent, 16 vota pro (1 votë me ngritje dore), kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 15 anëtarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet kërkesa për korrigjim të transferit të kategorive ekonomike në kategorinë paga dhe shtesa.

21. Shqyrtimi i Raportit të Punës së NJAB mbi nivelin e rekomandimeve për 2024.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: auditori i brendshem ka raportu sa auditime i ka kry që është obligim ligjorë për me i përfundu. Për vitin 2024 kanë qenë të planifikuara 8 auditime, 7 kanë qenë të përfundume të rregullta dhe në proces është 1 dhe ky ka përfundu por nuk është shkru në raport. Janë jep 17 rekomandime dhe prej tyre janë implementu 17 rekomandime të auditorit të

brendshem dhe 8 kanë mbetë tëpa u implementu, gjithësej auditori i brendshem i ka jep 25 rekomandime, po ashtu edhe keto rekomandime janë punë të auditorit të jashtëm.

22.Shqyrtimi i informatës se NPL-ve të Komuns s Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ju kemi dërgu me shkresë zyrtare përmes emailit për raportin që kanë me paraqit ndërmarja publike. Na ka ardh raportit nga “AMBIENTI” nga “Stacioni i autobusave”, të cilin e kemi përcjellë tek anëtarët e kuvendit. Menqëse sot nuk janë prezent me diskutu raportin, pasi që e kemi raportit mbetet të diskutojmë brenda anëtrave të kuvendit dhe ekzekutivit.

Z.Berat Ganiqi: i kam lëxuar dy raportet te N.P.L “Stacioni i Autobusave” që në vitin 2021,2022,2023 kanë operu me humbje dhe aty kanë paraqit vete të hyrat. Ndërsa në vitin 2024 pas muajit mars kanë fillu me operu vetëm me plus. Por qka është për dallim prej ktyre viteve të tjera kete vitë është se i sqarojnë të hyrat me peronizim edhe të hyrat tjera kanë pas për shkak të parkingut edhe për shkak të hapsirave të tjera të qirras, gjë që nuk janë pasqyru në vitin 2021,2022,2023 edhe nuk po e di ku e kanë pas zbritje e ku e kanë pas rritjen në peronizim, në të hyrat e qirras apo në parkingje këtu diqka spo përshtatet! Po ashtu te raportit i NPL “Ambienti” ata i kanë përfshi vetëm të hyrat por jo edhe shpenzimet, gjë që aty kam dilemat e mija, po ashtu në raportit i kanë përfshi njësit Deçan, Klinë, Istog dhe sa e di këta janë NPL dhe nese raportojnë, raportojnë vetëm për Pejë! Sepse kjo ndermarje po operon her si regjionale her si lokale spo mundet kerkush me kuptu, po ashtu në raportit nuk janë përfshi edhe largimet e zyrtarëve të tjerë se për çka janë largu. Është një raport shumë i manget sespe vetëm je duke i ditur të hyrat dhe nuk e din edhe shpenzimet se ku janë bo për qka janë bo, shpresoj që ta gjejnë mundin dhe të vin që para asamblesë të raportojnë dhe të ballafaqohen me të vërtetat .

23.Shqyrtimi i Planit Preliminar të Prokurimit për vitin 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: plani i prokurimit i specifikon projektet në mënyrë të detajuar duke u bazuar në planin e buxhetit që e kemi aprovu në shtator të këtij vitit.

24.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Nuk ka pasur.

25.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Z.Rajan Arapi: çka do të ndodhë me mirëmbajtjen e rrugve, meqenëse nuk është gjendja e mirë edhe si pasojë e kesaj e di që është edhe koha e ftoftë por intervenime emergjente se paku të kemi që të mos dëmtohem?


Kryetari Gazmend Muhaxheri: rrugen te Fidanishtja kemi pas presion të jashtëzakonshem përpjetëzen me ndreq, e kemi rregullu dhe mbas 3 diteve ka ardh Hidro Drini dhe është duke e vendos gypin e ri të ujit diku rreth 800m në këtë kohë kemi me pas prishje të rruges në Fidanishte. Mos me i lon po shkon investimi, me i lon i kemi ankesat e qytetarëve por edhe uji është duke u ndreq për interes qytetarëve. Po ashtu e kemi një problem që duhet prap me bo një rimarrveshje me ndërmarjen “I Hidro Drini” dhe ata me bo vet, sespe e kemi pa që ata me pagu të njëjtin operator që na e kemi na komuna, ndoshta dhe me u nda damin që e bëjnë me riparuar vet dhe mi jep afat 5-7 ditë me kry këtë punë. Sepse mandej neve po na del problem se na nuk jepim leje me punu prej tash deri kah marsi dhe ata e kanë operatorin dhe është duke punu tash me vendos ujin, po ashtu në seancë raportun që kemi me u ballafaqu edhe në vitin 2025 me këtë problem. Kjo është qka mundem me bo me këta operator sepse asfaltte nuk ka asnjë fabrikë që punon para fundit të marsit dhe fillimit të prillit.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 13:20 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalën zyrtarë në Youtube.

Kliko : <https://www.youtube.com/watch?v=IhPt2K-ZOZ0>

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina



KRYESUES I KUVENDI,

Rexhep Kurtbogaj

